



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#95

## LIBRAT/ Miratohet paketa e dokumenteve për tekstet e unifikuara mësimore për Diasporën



Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Evis Kushi dhe ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko miratuan dhe firmosën paketën e dokumenteve rreth procedurave të zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën, kriteret e recensuesve, si dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për Diasporën hartuar nga “Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”.

Kjo paketë e dokumenteve rreth procedurave të zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën, pritet të firmoset në ditët në vijim edhe nga z. Ramë Likaj, Ministër i Arsimit Dhe Shkencës i Republikës së Kosovës.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## TAKIMI/ Mbështetja për zhvillimin rural, bashkëpunimi si garanci për suksesin

Në një takim virtual mes Ministrit të Shtetit për Diasporën Pandeli Majko, Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ekonomi dhe Drejtorit Ekzekutiv të Dhomës së Biznesit të Diasporës z. Durim Tabaku u diskutua mbi mbështetjen në rritjen ekonomike-sociale të zonave rurale shqiptare në bashkëpunim me diasporën në Itali.

Ky takim vjen në kuadrin e punës parapërgatitore për fazën e implementimit të projektit “Mbështetje e prekshe në rritjen ekonomiko-sociale të zonave rurale Shqiptare duke përmirësuar kapacitetet e NVM-ve bujqësore në bashkëpunim me diasporën në Itali, nëpërmjet kontributit konkret dhe transferimit të njohurive” të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë dhe me mbështetjen financiare të IOM dhe Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## PROJEKTI/ Informacionet për Diasporën në një platformë për të gjitha institucionet



Ka nisur zbatimin i projektit për ridizajnimin e informacionit për Diasporën për institucionet shqiptare, një projekt i përbashkët ky mes ministrit të Shtetit për Diasporën dhe IOM Albania.

Në faqet elektronike të të gjitha institucioneve të përfshira synohet të krijohet menuja “Diaspora”, një kategori që do të përfshijë informacione për baza ligjore që i dedikohen Diasporës sipas fushës së veprimit të çdo Ministrie.

Institucionet e përfshira janë ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ajo e Drejtësisë, Kulturës, Bujqësisë, Turizmit dhe Punëve të Jashtme.

Shpërndarja e informacionit do të bëhet në bazë të fushave, si strategjia kombëtare e Diasporës, programi “Connect Albania”, rrjeti i profesionistëve, raportet e koordinatorëve shtetërorë, oficerët koordinues, etj.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## MARRËVESHJA/ “Biblioteka arbereshe” në duart e studentëve, QSPA bashkëpunim me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka firmosur një marrëveshje me fakultetin e Historisë dhe Filologjisë për të bashkëpunuar në fushën kërkimore e shkencore me institucionet e rëndësishme arsimore.

Duke patur parasysh karakterin mësimdhënës të institucionit, Prof. Kastrati propozoi që nga ana e fakultetit të parashikohej atashimi i studentëve pranë QSPA, për realizimin e stazheve dhe praktikave profesionale. Gjithashtu u propozua të parashikohet orientimi i temave të diplomave në fushat e kërkimit ku QSPA ushtron veprimtarinë, nën drejtimin e studiuesve të qendrës. Në këtë pikë, të cilën të dy përfaqësuesit e fakultetit e mirëpritën dhe e mbështetën me premtime se do të jetë e realizueshme që këtë vit akademik, QSPA angazhohet t'u vërë në dispozicion studentëve edhe bibliotekën e saj të pasur me libra që fokusohen në objektin e saj të punës.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Dhuro Libra



Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)